

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Macron jep alarmin për Rusinë/ Presidenti francez: Përgatitje për të mobilizuar 300 mijë trupa të tjera për luftën
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/macron-jep-alarmin-per-rusine-presidenti-francez-pergati-tje-per-te-mobilizu-i588459
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 06:54:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 06:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	151e17943b45484c3e2c18032b9956f038ecdc85ba9f4dcd7d0b9f8814754969
TEKSTI	0444acff23d815377a6efc4d62fff8accb85b5fa1e204e3b9495e60ecd84b1fb
PAMJA	3225fe32541798b7713ac60a964080b7c1352bcacdb14977f171a8b266990bce

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3d79b130f2fdf17ba370dc879afa0d187b0710cbe5a96bceb4a9649b88e5f92a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a38a4fa799b1e73bbabeaa0ef113694411dbd892b18eb619eb2f3db166512539
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3d79b130f2fdf17ba370dc879afa0d187b0710cbe5a96bceb4a9649b88e5f92a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1 e [Macron jep alarmin për Rusinë/ Presidenti francez: Përgatitje për të mobilizuar 300 mijë trupa të tjera për luftën](#) [Atentat në një lokal të Athinës, plagoset temija shqiptar/ fundit](#)

Macron jep alarmin për Rusinë/ Presidenti francez: Përgatitje për të mobilizuar 300 mijë trupa të tjera për luftën



26 Shtator 2026, 08:50Bota TEMA



Presidenti francez Emmanuel Macron ka deklaruar se së fundmi, ka disa sinjale se Rusia po përgatitet të mobilizojë 300 mijë trupa të reja për luftën në Ukrainë, duke e cilësuar si një mobilizim pas zgjedhjeve.

I pyetur në lidhje perspektivën e një raundi të mëtejshëm të mobilizimit rus, Macron deklaroi se informacioni ka ardhur nga shërbimet e inteligjencës dhe është e qartë se Rusia do ta ndërmarë këtë veprim.

“Ka pasur disa raporte të ndara nga shërbimet e inteligjencës evropiane dhe amerikane, si dhe nga miqtë tanë ukrainas. Zgjedhjet janë zhvilluar. Tani është e qartë se Rusia do ta bëjë këtë. Pyetja është nëse do ta shpallë publikisht apo do ta zhvillojë pa një njoftim zyrtar”, tha presidenti francez.

Macron i quajti sinjalet se Rusia po përgatitej të mobilizonte 300,000 ushtarë të tjerë “të besueshëm”, duke pretenduar se ka pasur “disa shenja se Rusia po organizohet për këtë”.

“Dhe me të vërtetë, skenari i besueshëm që diskutohet shpesh sot sillet rreth shifrës prej 300,000 njerëzish. Sinjali që Rusia po dërgon është se është gati për sakrificë edhe më të mëdha për të marrë kontrollin e të gjithë Donbasit”, tha Macron.

Komentet e tij erdhën pasi Zyra Presidenciale e Ukrainës paralajmëroi në gusht se Rusia mund të jetë duke u përgatitur të thërrasë 600,000 njerëz gjatë viteve 2026 dhe 2027, mes rritjes së pakënaqësisë publike me luftën dhe një rënijeje të numrit të njerëzve të gatshëm të rekrutohen vullnetarisht.

Ndërkohë, Ukraina është përfshirë sërish nga një valë e gjerë sulmesh ajrore ruse. Gjatë natës dhe mëngjesit të së premtes, dronë dhe raketa ruse goditën disa rajone të vendit, me pasojat më të rënda në Kiev, Odesa dhe Zaporizhzhia, duke vrarë 7 persona, përfshirë një 14-vjeçar.

Si pasojë e sulmeve, këtë të premte u godit edhe prodhuesi më i madh i çelikut në Ukrainë, duke e detyruar të mbyllte aktivitetin.

Mbyllja është një tjetër goditje për sektorin dikur të fuqishëm të çelikut të Ukrainës, i cili më parë përbënte 15% të eksporteve të vendit, por është vënë nën presion nga sulmet ruse dhe kufizimet nga BE-ja, partneri i saj kryesor tregtar.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Eric Wendt nis sot misionin si ambasador i SHBA-së në Shqipëri, do t'i dorëzojë letrat kredenciale Begajt](#)

08:30 Bota

Trump refuzon armëpushimin me Iranin, pritët rifillimi i bombardimeve pas zgjedhjeve të nëntorit

08:20 Bota

SHBA po planifikon hyrjen ushtarake në Kubë

07:51 Bota

"Rifillim i marrëdhënieve mes dy vendeve"/ Gjermania dhe Hungaria rikthejnë bashkëpunimin ushtarak dhe forcojnë lidhjet në NATO

07:32 Bota

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.